



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

**Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
Ekzekutivi i Mamushës pajtohet për blerjen e një aparati të Ultrazërit**

16 maj 2013, Mamushë

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Mamushës" ka marrë pjesë në mbledhjen e kryetarit të komunës, Arif Butuc me drejtorët komunal, ku janë miratuar një varg konkluzionesh. Për shkak se këto vendime kanë të bëjnë me interesin publik, EC Ma Ndryshe për hir të rritjes së transparencës së ekzekutivit lokal, tani e tutje do t'i publikoj vendimet e marra nga qeveria komunale e Mamushës.

Ekzekutivi i komunës së Mamushës në takimin e fundit ka miratuar propozimin e Drejtorisë për Shëndetësi për blerjen e një aparati të Ultrazërit, që do t'i shërbej pacientëve të komunës në Kujdesin Parësor Shëndetësor. Po ashtu qeveria lokale ka miratuar konkluzionin në lidhje me pagesën e dy mjekëve në Kujdesin Parësor Shëndetësor, të një mjeku internist dhe një pediatri, që veprimtarinë e ushtrojnë në kuadër të Qendrës së Mjekësisë Familjare.

Qeveria komunale është pajtuar edhe me propozimin e Drejtorisë për Shërbime Publike për riparimin e ndriçimit publik në qytet sikurse edhe iniciativën e kësaj drejtorie për pastrimin e Parkut.

Në takim, Drejtorja për Ekonomi dhe Financa ka ngritur shqetësimin në lidhje me planifikimin dhe ndarjen e Grantit Qeveritar 2014-2016, veçanërisht për Arsim dhe Shëndetësi, me ç'rast është theksuar se ky planifikim nuk përputhet me nevojat reale të komunës së Mamushës.

Ekzekutivi lokal është informuar nga Drejtorja për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, në lidhje me projektet për ndërtimin e fushave sportive, në shkollat e Mamushës, në saje të bashkëpunimit të komunës me IOM-in. .

Në këtë takim, drejtori i administratës ka ngritur çështjen e përdorimit të gjuhës turke në regjistrin civil dhe ka kërkuar nga drejtorja e Administratës që të intensifikohet komunikimin me MPB-në për zgjidhjen e këtij problemi, që është shfaqur me futjen në përdorim të softuerit të ri për gjendjen civile.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe

Rr."Saraçët" Nr.5- Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 77



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Mamushës" përkrahët financiarisht nga
Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*